



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.296/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Koalicioni PDK-AAK, për shkak të vendosjes së posterave afër Qendrave të Votimit (QV) gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr. 296/2017 e datës 12.06.2017 e parashtruar nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se në vendvotimin në shkollën Ibrahim Rugova në Obiliq kanë hasur materiale propaganduese të kandidatit nga radhët e koalicionit PDK-AAK, Fatmir Xhelili. Parashtruesi i ankesës pretendon se kjo është në kundërshtim me nenin 36 pika a) të LZP.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar. Nga fotot e ofruara nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë Qendra e Votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr 296/2017 më datën 14.06.2017

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*